



STINËT NDRYSHOJNË



NE MBESIM
DEMOKRATË

JA SE ÇFARË TË DREJTA KEMI NE

LEOTRIM (12), GJON (11), LEONITA (12), VITORE (11), ALEKS (11)



Lexues të dashur, sot do të flasim për demokracinë. Ne kemi shumë dëshirë që edhe ju të mësoni për këtë temë. Prandaj, kemi shkruajtur këtë artikull për ju. Shpresojmë që t'iu pëlqej

Këtë artikull dëshirojmë ta fillojmë duke iu treguar disa fakte për demokracinë. Demokracia është formë e qeverisjes ku udhëheq populli. Kjo fjalë rrjedh nga greqishtja e lashtë. Fjala „demos“ do të thotë popull, ndërsa „kratia“ do të thotë rend, apo udhëheqje.

Demokracia për herë të parë është paraqitur në kryeqytetin e sotëm të Greqisë që është Athina, në vitin 507 p.e.s. Athina në atë kohë nuk ka qenë kryeqyteti i Greqisë, por ishte një shtet-qytet shumë i famshëm. Aty jetonin shumë mendimtarë të mëdhenj dhe të zgjuar. Këta dhanë idenë për formimin e demokracisë së drejtpërdrejtë. Edhe sot ekziston kjo demokraci në disa shtete të ndryshme. Sipas kësaj demokracie, po-

pulli mund të marr pjesë në takimet vendimmarrëse ku diskutohen në detaje të gjitha çështjet e rëndësishme për qytetarët. Fatkeqësisht, këto takime nuk ishin aq të drejta për shkak se nuk përfshiheshin të gjithë qytetarët. Kjo nuk ishte demokraci e mirëfilltë dhe njerëzimit iu desh një kohë e gjatë për ta zhvilluar demokracinë siç është sot.

Tani ne udhëheqim vendin tonë me po të njëjtat parime demokratike, mirëpo në udhëheqje përfshihemi që të gjithë. Në demokracinë e sotme nuk ka hapësirë për dallime apo diskriminim, pasi që të gjithë qytetarët janë dhe duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Kurse, disa nga parimet e demokracisë janë: barazia, toleranca, pjesëmarrja aktive, vota e lirë, të drejtat e barabarta për të gjithë, etj. Pa këto parime, kjo formë e udhëheqjes nuk do të ekzistonte. Ndërsa, ne nuk do të ekzistonim pa këtë formë të udhëheqjes.



Fytyrat tona punëtoze tregojnë shumë



Këtu jemi ne duke punuar me shumë zell

Ne diskutim për demokracinë, por çfarë të drejta gëzojmë në këtë formë të udhëheqjes nuk ua thamë akoma. Vazhdoni leximin, në mënyrë që të mësoni më shumë mbi këtë temë

Në fshatin tonë fatkeqësisht ne njohim një djalë të vogël i cili nuk vie në shkollë me rregull. Neve na vie shumë keq për këtë djalë të vogël dhe kemi shumë dëshirë ta shohim edhe atë në mesin tonë.


Një ditë prej ditësh vendosëm të shkonim në shtëpinë e tij që të bisedojmë me të dhe ta bindim të vinte në shkollë. Pasi shkuam tek shtëpia e tij, ne i treguam se sa i rëndësishëm është arsimi dhe edukimi në jetën tonë. „Në shkollë ne mësojmë gjëra të reja, marrim aftësi të reja, bëjmë shokë dhe shoqe, luajmë lojëra të ndryshme, argëtohemi së bashku dhe bëhemi qytetarë të mirë,“ i thamë atij. Pas bisedës sonë, ai ndryshoi mendimin e tij dhe që nga e nesërmja filloi të vinte në shkollë. Ne kështu bëmë një shok të ri dhe u përpo-

qëm me gjithë zemër t'i ndihmojmë në çdo gjë që ai kishte nevojë.


Në demokraci ne e gëzojmë të gjithë të drejtën e arsimimit, e cila për ne është e drejta më e rëndësishme. Ama, jo vetëm. Ne kemi të drejtë të kemi një emër dhe mbiemër, të kemi një familje dhe një shtëpi të sigurt, të lëvizim dhe të kemi një pasaportë shtetërore, të flasim lirshëm, t'i shprehim mendimet tona lirshëm dhe të jemi vetvetja. Këto të drejta mbrohen edhe nga dokumente shumë të rëndësishme ndërkombëtare, siç është Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Andaj, ne vetë sigurohemi që të gjithë fëmijët po i shfrytëzojnë këto të drejta kaq të mira. Kjo sepse edhe ne fëmijët jemi pjesë e demokracisë!



Shoku ynë, pas bisedës sonë



Në çdo gjë dhe kudo, ne kemi dëshirë të jemi të barabartë




Të lirë, të dëlirë, paqësor dhe aktiv



Unë dhe miku im më i mirë!



Një lule për ty, një lule për mua, një lule për të gjithë



Rrotull botës të ndryshëm, por gjithmonë të respektueshëm


NXËNËS AKTIV JEMI NE

MIMOZA (11), ERMELANDI (11), MARK (10), SYLË (11)



Po, po, ne jemi nxënës aktiv. Pse jemi të tillë, lexojeni në artikullin tonë të shkruar nga duart tona të arta

Se jemi në kërkim të dijes e dëshmon fakti që ne e quajmë veten nxënës. Por, që vie dita kaq shpejt që ne të mësojmë edhe për rolin që e kemi në shtetin tonë, nuk e kemi menduar. Këtë e themi, sepse sot ne nxënësit nga Gjakova, patëm rastin të mësojmë se çka i dallon qytetarët mes vete. Ky dallim vërehet nga aktivizimi dhe vullneti i tyre i lirë dhe i mirë për të



Qytetarët aktiv janë ata të cilët zbatojnë ligjet dhe rregullat, andaj këta qytetarë janë të kujdesshëm

vepruar dhe zhvilluar shtetin ku jetojnë. Këta persona janë të njohur me emrin *qytetarë aktiv*, duart e të cilëve janë të arta.

Mbaj mend rastin kur unë Landi së bashku me shokët e mi duke kaluar pranë një ambienti të gjelbërt, rastësisht hasëm në disa mbeturina të djegura të hedhura nga disa qytetarë, të cilët nuk e duan zhvillimin e ven-



dit të tyre. Andaj, ne u ndalëm, propozuam ide se si ta pastrojmë. Shkuam në shtëpitë tona ku morëm mjetet e punës dhe plot vullnet pastruam tërë hapësirën e gjelbërt. Kjo hapësirë siguron ajrin e pastër që ne e thithim çdo ditë.

Kështu, ne u bëmë model për shumë qytetarë të tjerë, të cilët fillimisht hezituan që të na ndihmojnë. Por, duke e parë se si ambienti po merrte pamje tjetër nga pastrimi, ata u bashkangjitën me ne dhe së bashku e realizuam një detyrë që hyn në kuadër të veprimeve të qytetarëve aktiv. E që të cilësohemi qytetarë aktiv ka shumë gjëra që mund të bëjmë. Nga vullneti i mirë asnjë njeri nuk ka përjetuar diçka të keqe. Andaj, ju lutemi që të reflektoni mbi veprimet tuaja. Me të njëjtat duart që mund të bëni dëme, po me të njëjtat mund të bëni mrekulli. Varef nga ju se si keni vendosur ta shfrytëzoni potencialin tuaj. Nëse bëni veprime të mira ne do të vijmë pas jush. E jo vetëm ne, por shumë qytetarë të tjerë!



Këta jemi ne. A nuk po dukemi si jye?

EDHE VOTA JUAJ KA VLERË

FLORIAN (10), MARSEL (10), LUIS (11), FLORESITA (11)

Ne, gazetarët e vegjël sot e patëm një mundësi ideale që të mësojmë shumë fakte rreth demokracisë, por po ashtu edhe rreth zgjedhjeve. Se çka diskutuam dhe mësuam për zgjedhjet do të mësoni nga artikulli ynë, kurse për demokracinë u informuat nga artikulli në faqen 2. Lexim të këndshëm!

Në të gjitha vendet e botës, ku si sistem i qeverisjes ekziston demokracia, zgjedhjet zënë vend shumë të të rëndësishëm. E njëjta vlen edhe për vendin tonë. Qytetarët e Kosovës janë të lirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor, pasi të arrijnë moshën 18 vjeçare. Ata marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve; në zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare.

Në zgjedhjet lokale qytetarët votojnë për përfaqësuesit komunal, të cilët janë kryetari i komunës dhe asamblistët. Kurse, në zgjedhjet parlamentare qytetarët votojnë për deputetët, të cilët njihen edhe si përfaqësues të popullit. Mandati si i përfaqësuesve të nivelit komunal, si i atyre parlamentar është 4 vjeçar.



Grup i vogël, por me vlerë shumë të madhe




Për rëndësinë e votës duhet që të dijnë të gjithë, andaj ju treguam shembullin për klasën tonë

Ne, kemi një mesazh për ju lexues, të cilin ia treguam edhe edukatores sonë. Ne votojmë për veten tonë, sepse përmes votës ne përfaqësojmë interesat tona, besimin për zhvillim dhe përfaqësim. Vota është një letër e vogël për nga përmasat, por e madhe për nga rëndësia. Aq e madhe sa që nëse i adresohet personit të duhur, mund të bëjë mrekullira. Prandaj, vota duhet të vlerësohet. Sepse ajo është prona personale e çdokujt prej nesh, e cila nuk jepet me qera, nuk jepet hua dhe as nuk shitet. Duhet t'i japim votës rëndësinë që i takon, pasi që vetëm në këtë mënyrë mund ta zhvillojmë shtetin tonë dhe ta çojmë përpara. Nëse ky mesazh i ynë arrin të kalojë deri tek ju, ne do të ishim tejet të lumtur.

Rëndësia e një vote

Në demokraci, ashtu siç ka rëndësi çdo qytetar, ashtu ka rëndësi edhe vota e tyre. Ka shumë raste që vetëm për një votë janë bërë ndryshime shumë të mëdha. Ne do t'iu tregojmë një shembull se si për një votë klasa jonë ka mbetur pa zgjedhur kryetarin e klasës. Ditën kur është dashur të zgjedhet kryesia e klasës, një shoqe e jona mungoi. Por, prapë ne vazhduam procesin edhe pa të. Momenti kur më së shumti e vërejtëm rëndësinë e saj ishte momenti kur numëruam votat. Votat ishin të barabarta për të dy shokët tanë, kështu që ne i anuluan zgjedhjet për atë ditë, sepse kishim nevojë edhe për votën e saj, që njëri nga kandidatët të fitoj.



Kjo peshore tregon barazinë gjinore



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Engjëll Gjoni“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V
Website: www.demos-ti.org Vendi: Novosellë e Ulët, Gjakovë